



Universiteti "Kadri Zeqa" Public University	
Pranuar	04.02.2021
Nesht	01/212

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes të:

UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA"

DHE

NTSH INFOTECH



Universiteti “Kadri Zeka”, Gjilan (në tekstin e mëtejme UKZ), i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Asoc. Dr. Bajram KOSUMI dhe Infotech Academy, i përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Burim Sherifi, pajtohen të bashkëpunojnë në ngritjen profesionale të studentëve të UKZ-së, të ofrojë laboratorët e tyre për qëllime të përbashkëta, të rekrutojë stafin e ardhshëm mundësisht edhe nga studentët praktikant të UKZ-së, të jetë bashkëpunëtorë i ngushtë i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike për krijimin e programeve të reja studimore, me interes të përbashkët, hyn në Marrëveshje Bashkëpunimi sipas kushteve të mëposhtme duke qenë partner serioz edhe gjatë proceseve të akreditimit të FSHK-së.

Neni 1 **Qëllimi**

1.1 Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve, në bazë të cilave **UKZ-ja** dhe **Ntsh InfoTech Academy**, pajtohen ti realizojnë.

Neni 2 **Fushat e Bashkëpunimit**

2.1 Realizimi i punës praktike të studentëve të Universitetit “Kadri Zeka” në NTSH InfoTech. Kushtet e pranimit të studentëve për praktikë në NTSH Infotech do të vendosen bashkërisht nga të dy palët.

2.2 InfoTech Academy ofron për të gjithë studentët e Universitetit “Kadri Zeka” një sërë trajnimesh nga Cisco Academy pa pagesë siç janë:

- Introduction to Internet of Everything
- IoT Fundamentals: Big Data & Analytics
- Introduction to Syber Security
- Entreprenueship
- NDG Linux I
- Get Connected
- Introduction to Packet Tracer

Kohëzgjatja e këtyre trajnimeve do të jetë 3-6 muaj që ti përfundojnë për secilin trajnim.

2.3 InfoTech Academy për të gjithë studentët e dalluar ofron 30% zbritje për trajnimet e Cisco-s si në vijim:

- IT Essentials (kohëzgjatja 3-4 muaj)
- Cisco CCNA New I,II,III (kohëzgjatja 8-10 muaj)
- Cisco CCNP Encor (kohëzgjatja 4-5 muaj)



UNIVERSITETI • UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"



- Krimet Kompjuterike (kohëzgjatja 4-6 muaj)
- Windows Server fundamentals 2016 (kohëzgjatja 2-3 muaj)
- C# (C Sharp) (kohëzgjatja 3-4 muaj)
- Java (kohëzgjatja 6-8 muaj)
- Java Script (kohëzgjatja 8-10 muaj)
- Python (kohëzgjatja 3-4 muaj)
- Etj

2.4 Profilizimi dhe specializimi post diplomik në:

- Network engineering
- Cyber Security
- Java Developer
- HTML Developer
- Python Developer

Me ç'rast të sapodiplomuarit do të bëjnë praktikën në projekte reale dhe konkrete, e cila do të përgadis direkt për treg të punës.

2.5 Promovimi i nismave të përbashkëta profesionale dhe akademike të cilat kanë për qëllim avancimin e objektivave të palëve nënshkruese.

2.6 Shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënave jo të kufizuara që kanë për qëllim zbatimin e Marrëveshjes.

2.7 Ofrimi i personelit të specializuar me qëllim të ofrimit të ligjëratave për vetëdijesimin e studentëve të UKZ në lidhje me fushën që NTSh Infotech Academy e mbulon.

2.8 UKZ-ja do të mbështes NTSh Infotech Academy në ngritjen e kapaciteteve profesionale të personalit të saj, me programet e saj arsimore në të gjitha nivelet.

2.9 UKZ-ja do të mbështes NTSh Infotech Academy me stafin e vet akademik në pjesëmarrje në trajnime të ndryshme apo ligjëratave, sipas kërkesave edhe për seminare dhe konferenca të ndryshme që NTSh Infotech Academy organizon.

Neni 3

Kushtet e zbatimit të Marrëveshjes

3.1 Palët do të sigurojnë që Bashkëpunimi do të realizohet në përputhje me këtë Marrëveshje.

3.2 Asnjë nga palët nuk angazhohet për detyra specifike, përveç atyre të specifikuar në këtë Marrëveshje.

3.3 Asnjë nga palët nuk është e ngarkuar me detyrime financiare ndaj zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta siç specifikohet me këtë Marrëveshje. Çdo detyrim financiar që mund të lindë për zbatimin e Marrëveshjes, duhet të rregullohet dhe aprovohet paraprakisht nga palët në formë të shkruar.

3.4 Për të siguruar një komunikim të vazhdueshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshje, secila nga palët do të caktojë nga një person kontaktues.



- 3.5 Në rast të publikimeve të materialeve promovuese, përmbajtjet e tyre duhet të konfirmohen nga të dyja palët para publikimit të tyre, me qëllim të shmangies së publikimit të ndonjë promocioni/informate pa dijeninë e palëve nënshkruese.
- 3.6 Për të përfituar këto beneficione studentët duhet të sjellin aprovimin nga UKZ-ja (sekretariati i UKZ-së)

Neni 4

Interpretimi dhe ndryshimi i kësaj Marrëveshje

- 4.1 Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit është përpiluar në 2 (dy) kopje origjinale, një për secilin palë.
- 4.2 Interpretimi i kësaj Marrëveshje do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur pranimin e reciprocitetit.
- 4.3 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga te dyja palët.

Neni 5

Hyrja në fuqi

- 5.1 Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e udhëheqësve (drejtuesve) të UKZ-së dhe NTSh InfoTech Academy, përkatësisht të përfaqësuesve të tyre të autorizuar e cila është valide që nga nënshkrimi i dy palëve.

Gjilan, 04/02/2021

PALËT NËNSHKRUESE

Universiteti "Kadri Zeka"

Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi
Rektor

NTSH InfoTech Academy

Burim Sherifi
Menaxher

